

---

## **AKT THEMELIMI**

### **"ALBANIAN AVIATION MANAGEMENT" SHPK**

#### **1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë "**ALBANIAN AVIATION MANAGEMENT**" **SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

#### **2. Ortaku i vetëm i shoqërisë është:**

- "**KASTRATI AVIATION HOLDING**" **SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.

#### **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Ofrimi i shërbimeve menaxheriale dhe konsulencës teknike, ligjore, financiare, administrative, organizative dhe shërbimeve të tjera të ligjshme të çdo lloji në industrinë ajrore.
- Shërbimet e shoqërisë konsistonë por pa u kufizuar në shërbime të operimit dhe menaxhimit të aeroporteve, trajnime për rritjen e efektivitetit dhe sigurisë teknike dhe jo vetëm në sektorin e aviacionit civil dhe sektorët e tjërë që kanë lidhje me operimin e strukturave dhe faciliteteve të aviacionit civil, përmirësimin finanziar, automatizimin dhe dixhitalizimin e proceseve të aeroporteve apo shoqërive të linjave ajrore.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjeter që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### **4. Selia e shoqërisë**

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare

dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

## 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimitarës së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## 6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 5,000,000 (pesë milion lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 5,000,000 (pesë milion lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

## 7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## 8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Znj. Erinda Xhaferaj, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 16.06.1989, banuese në Tiranë, e identifikuar nga karta e identitetit me nr. 035577557 dhe nr. personal I95616062W.**


## 9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**ORTAKU I VETËM**

**SHOQËRIA "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK**

Përfaqësuar nga Zj. Eda Spahiu

  
Eda Spahiu  
Sh.p.k.

KASTRATI AVIATION HOLDING  
NUIS: M21612025K  
TIRANA - ALBANIA

[emër, mbiemër, firmë, vulë] - 19.04.2022